



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:043726
KA.nr.1141/22
Datë: 23.01.2025
Numri i dokumentit: 06771665

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Bajgora Trans” SH.P.K, me seli në Vushtri, me përfaqësues të autorizuar A.M pronar, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak të anulimit të vendimit me nr. KA 028/2022 të datës 01.02.2022, jashtë seancës, me datë 23.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit “Bajgora Trans” SH.P.K, me seli në Vushtri, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak të anulimit të vendimit me nr. KA 028/2022 të datës 01.02.2022.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Bajgora Trans” SH.P.K, me seli në Vushtri, me përfaqësues të autorizuar A.M pronar, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak të anulimit të vendimit me nr.KA 028/2022 të datës 01.02.2022.

Gjykata me datë 02.12.2024 paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t’a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform

nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 10.12.2024, ndërsa edhe pas kalimit afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë. Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia, dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm
KA.nr.1141/22, me datë 23.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.